



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:072526

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06018420

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Burhan Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit J. L. me numër personal ..., me vendbanim në fshatin ... Hani i Elezit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokagt K. M. nga zyra ligjore "...” Ferizaj.rr “Naim Frashëri” pn. kundër të paditurit Byroja Kosovare e Sigurimit -Fondi i Kompenzimeve me seli në Prishtinë, përkompenzimin e dëmit, jashtë seance, më datë 05.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet se padia e Paditësit J. L. në këtë çështje kontestimore, është **TËRHEQUR**.

II.OBLIGOHET pala paditëse që të paguaj shumën prej 20.€ në emër të taksës për padi.

A r s y e t i m

Paditësi J. L. me numër personal ..., me vendbanim në fshatin ... Hani i Elezit ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt. 04.03.2024, lidhur me çështjen kontestuese kompenzim dëmi .

Paditësi përmes parashtresës së dt. 27.05.2024 e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese paditësi me të paditurën qështjen kontestuese e kanë zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore me marrëveshje.

Gjykata vendosi që të pranoj të tërhequr padinë e paditëses në kuptim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës kontestimore, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e

lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e morri konform nenit 12.1 të UA, të KGJK-së nr. 01/2017 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe e detyroi palën paditëse që të paguaj shumën prej 20.€ në emër të taksës për padit të pa paguar me rastin e dorëzimit të padisë.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2024:072527 dt. 05.08.2024

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi

nuk është e lejuar ankesa

Numri i lëndës: 2024:072526
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06018420